



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKANUN		QEVERIA E KOSOVËS - VLADA E KOSOVËS	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR		MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Njësia Org. Org. Jedinice Org. Unit	DU	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.:	3492/12
Nr i faqeve Ish. Stranica No. Pages	04	Data: Datum: Date:	20.06.2013
Prishtinë / a			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Opsteg Sekretara/Office of the General Secretary

DATË/A:	18.06.2013
REFERENC-Ë:	3492/12 -ZSP- 481/2013
PËR/ZA/TO:	PTU "AQUA -SANA" K. Klllokot
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben ÇITAKU, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	VENDIM



Sipas kërkesës suaj me nr. të protokollit: 3492/12 organi kompetent i MMPH-së ka shqyrtuar aplikacionin për Leje Ujore dhe ka vendosur si në Vendimin e bashkangjitur të kësaj letër përcjellëse.

Me respekt !

Faqe 1 nga 4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Stalnoq Sekretara/Office of the Permanent Secretary

Në bazë të nenit 56 të Ligjit mbi Ujërat e Kosovës (Rr Nr. 2004/24) dhe nenit 90 të Ligjit për Procedurë Administrative (Nr. 02/L-28), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, lëshon këtë:

LEJE UJORE

APROVOHET kërkesa e kompanisë PTU "AQUA – SANA". K. Kllokot për Leje Ujore, lidhur me shfrytëzimin e ujit nëntokësor nga pusi që gjendet në parcelën me nr. 1034, zona kadastrale Kllokot, K. Kllokot, si pronë e paluajtshme P-73701026-01034-2.

Leja Ujore jepet me këto kushte :

- Sasia maksimale e ujit të shfrytëzuar nga Pusi 1, të jetë siç është paraparë me dokumentacion investivo – teknik:
- $Q_1=2.2$ l/s (Dy pikë dy litra për sekondë);
- Që në ambalazhin e prodhimit të shënohet edhe numri i Lejes Ujore si dhe emërtimi nga institucioni përkatës;
- Pala përmes regjistrimit me anën e ujëmatësve duhet të evidentoj: Prurjen mesatare ditore (l/s), sasinë ditore (m^3 /ditë), sasinë vjetore (m^3 /muaj) dhe sasinë vjetore (m^3 /vit). Për sasinë e shfrytëzuara pala obligohet që për çdo tre muaj të informoj me shkrim MMPH-në;
- Obligimi për pagimin e kompensimeve për shfrytëzimin e ujërave, do të përcaktohet me aktvendim të posaçëm nga MMPH-ja, sipas U.A. Nr. 06/2006, për Strukturën e Pagesave të Ujit ;
- Pala obligohet që për çdo muaj të informoj me shkrim MMPH-në lidhur me sasinë e shitura të ujit, duke ju referuar U. A. Nr. 06/2006, për Strukturën e Pagesave të Ujit.

Faqe 2 nga 4



- Të hartoj elaboratin për shkarkimin e ujërave i cili përveç kushteve të parapara me Udhëzimin Administrativ mbi Përmbajtjen, Formën, Kushtet dhe Mënyrën e Lëshuarjes dhe Ruajtjes së Lejes Ujore, U. A. Nr. 24/05 duhet të përmbajë edhe këtë karakteristikë specifike;
- Zgjidhjen ideore të shkarkimit me ndikim në mjedisin pritës sipas Udhëzimit Administrativ mbi Vlerat Kufizuese të Efluentit që shkarkohen në Trupin Ujor dhe në Rrjetin e Kanalizimit Publik, Nr. 13/2008
- Elaboratin për zonën e mbrojtur ujore, sipas Udhëzimit Administrativ “Kriteret Për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Ujore dhe Masat e Tyre Mbrojtëse Për Burimin e Ujit që Përdoret Për Pije, Nr. 13/2007;
- Kushtet e shënuara për plotësim në pikat paraprake, pala duhet t’i plotësojë në afatin kohor prej 6 (gjashtë) muajsh në të kundërtën organi vendimmarrës do të silltet sipas nenit 58.1. pika d të Ligjit për Ujërat e Kosovës me nr. 2004/24;
- Leja Ujore jepet në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, me mundësi zgjatjeje sipas kërkesës së palës;
- Për vazhdimin e kohëzgjatjes së Lejes Ujore, bartësi është i obliguar që së paku 6 (gjashtë) muaj para skadimit të afatit të paraqes kërkesë për vazhdim të përdorimit;

Rekomandim: Pala duhet të aplikoj për Leje Ujore për shkarkimin e ujërave të ndotura, në afat kohor prej 6 (gjashtë) muaj.

Arsyetim

Sipas kërkesës me Nr. të protokollit: 3492/12, PTU “AQUA –SANA” K. Kllokot, ka aplikuar për Leje Ujore lidhur me shfrytëzimin e ujit nëntokësor nga pusi që gjendet në parcelën me nr. 1034, certifikata me nr. P-73701026-01034-2, Zona Kadastrale Kllokot për furnizimin e fabrikës së ujit që gjendet në po të njëjtën parcelë 1034, certifikata me nr. P-73701026-01034-2,, Zona Kadastrale Kllokot. Pala kërkesës ia ka bashkangjitur dokumentacionin investivo- teknik si ne vijim:

1. Formularin e aplikimit për Leje Ujore;
2. Pagesën e faturës nr. 000105;
3. Pëlqimi mjedisor;
4. Elaborat për leje ujore për ambalazhimin e ujit natyral mineral dhe te gazuar;
5. Certifikat e numrit fiskal;
6. Certifikata e regjistrimit të kompanisë “Aqua –Sana”;
7. Certifikata e regjistrimit të kompanisë hartuese;
8. Diploma e hartuesit ;
9. Vendimi për hartuesin nga kompania përkatëse;
10. Leje profesionale për prodhimin e produkteve ushqimore ;
11. Leje teknike – teknologjike per prodhimin e produkteve ushqimore
12. Skica;
13. Certifikatën për pronën e paluajtshme;

Faqe 3 nga 4



14. Fletë posedimi ;
15. Analiza fiziko- kimike dhe mikrobiologjike e ujit;
16. NNT "GLOBAL PROJECT" –Deklaratë (kompania);
17. Parametrat hidrogeologjik të puseve;
18. Analiza e hargjimit të ujit

Gjatë vizitës në teren, datë 16.06.2013, është konstatuar se ekziston objekti i ndërtuar i fabrikës si dhe pusi për furnizim të fabrikës në Kllokot, me këtë rast është mbajtur procesverballi i nënshkruar nga pala dhe zyrtar i DU-së .

Në bazë të dokumentacionit – investivo teknik të dorëzuar, shikimit në vend dhe në harmoni me politikat zhvillimore ekonomike të Kosovës është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE :


Pala e pakënaqur, ka të drejtë në iniciimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën Kompetente të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Nr. 3492/12- ZSP - 481/13 datë 18.06.2013
Prishtinë

T'i dërgohet :

1. Palës
2. Kabinetit të Ministrisë
3. Zyrës së Sekretarit të Përhershëm
4. K. Kllokot
5. AKMM-së
6. Inspektoratit
7. DU-së
8. Arkivit të MMPH-së

Sekretar i përgjithshëm


Arben CITAKU
